

janë bashkangjitur UÇK-së menjëherë pas fillimit të konfliktit në Kosovë. Besimi kishte shkuar disa herë në Shqipëri për shkak të furnizimit të UÇK-së me armatime. Faiku ka organizuar rezistencën kundër pjesëtarëve të forcave serbe në rajonin e fshatit Carrabregu i Ulët/Donji Crnobreg. Besimi dhe Faiku kanë rënë më **2.06.1998**, duke e mbrojtur fshatin **Carrabregu i Ulët/Donji Crnobreg**. Pjesëtarë të UÇK-së i kanë varrosur Faikun dhe Besimin në një fushë të fshatit, ndërkaq mbetjet e tyre mortore u rivarrosën pas lufte, në muajin shtator të vitit 1999, në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Glllogjan/Glodane.

Burimet: J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596; deklarata S.D, FDH-12203.

Valdet (Muzli) Kuçi

(11.10.1969, shqiptar nga Deçani/Deçane, punëtor, dy fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Valdeti u punësua në ndërmarrjen *Gjeravica/Deravica* në vitin 1992, por u pushua nga puna pas tetë muajsh. Ka marr pjesë në demonstratat kundër regjimit serb. Edhe para që t'i bashkëngjitej UÇK-së, e ndihmonte atë me sigurimin e ushqimit dhe uniformave. Në datën **2.06.1998**, Valdeti u vra gjatë luftimeve me forcat serbe në **Carrabregun e Epërm/Gornji Crnobreg**. Trupi i tij nuk u gjet kurrë. Rasti i tij është i sistemuar në regjistrin e të zhdukurve të KNKK-së me numrin rendor BLG-803250-01.

Burimet: J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795.

Sabrije (Nezir) Tolaj

(1932, shqiptar nga Pobergjja/Pobrde, komuna e Deçanit/Deçani, amvise)

Sabrija ishte gruaja e dytë e Beqir Tolajt. Ajo jetonte në shtëpinë familjare në fshatin Pobergjë/Pobrde, së bashku me gruan e parë të Beqirit, Sofën, si dhe me djalin e Beqirit dhe Sofës, Egzonin. Kur më **30.05.1998**, forcat serbe u pozicionuan pranë fshatit, të gjithë familjarët u larguan në **Irznić/Rznić**, përpos Sabrisë. Një ditë

më vonë edhe ajo u bashkëngjiti familjes. Por, ditën tjetër, Sabrija u nis nga Irzniqi/Rznić për në shtëpi në Pobergjë/Pobrde, që ta lëshonte bagëtinë në kullotë. Ishte kjo hera e fundit kur familjarët e panë të gjallë. Zhdukja e saj është e evidentuar nga KNKK-ja, në dosjen me numrin rendor BLG-803313-01.

Burimet: deklarata S.T, FDH-18712; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795.

Sylejman (Ukë) Zekaj

(03.08.1930, shqiptar nga Carrabregu i Epërm/Gornji Crnobreg, komuna e Deçanit/Deçani, shofer, katër fëmijë)

Sylejmani me bashkëshorten e kanë braktisur fshatin më 29.05.1998, përderisa forcat serbe e sulmonin Carrabregun e Epërm/Gornji Crnobreg. Fëmijët e tyre ishin larguar nga fshati vetëm disa ditë më parë dhe kanë gjetur strehim te farefisi në Prapaqan/Prapaçane. Sylejmani ishte nisur t'i vizitonte fëmijët më 2.06.1999, ndërkaq ditën tjetër, më **3.06.1998**, së bashku me kushëririn Haxhi Brucajn, e mori rrugën e kthimit për në Carrabregun e Epërm/Gornji Crnobreg. Sipas fjalëve të Haxhiut, kur ata arritën në **Carrabregun e Ulët/Donji Crnobreg**, përderisa po kalonin përmes fushës, në afërsi të shtëpisë së familjes Loshaj, forcat serbe hapën zjarr dhe Sylejmanin e qëlluan për vdekje. Trupi i tij ka mbetur në vendin e vrasjes deri në muajin tetor të vitit 1998, kur situata e sigurisë u qetësua përkohësisht. Atëherë, familjarët e tij u nisën për të kërkuar trupin e tij. E gjetën në vendin e vrasjes dhe e varrosën në të njëjtin vend. Pas përfundimit të luftës, më 28.07.1999, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet mortore të Sylejmanit në varrezat e Carrabregut të Epërm/Gornji Crnobreg.

Burimi: deklarata Z.H, FDH-17893.

Rexhep (Musë) Mazrekaj

(19.01.1959, shqiptar nga Drenoci/Drenovac, komuna e Deçanit/Deçani, zanatli, katër fëmijë)

Selmon (Tahir) Dukaj

(8.11.1960, shqiptar nga Drenoci/Drenovac, komuna e Deçanit/Deçani, pedagog, tre fëmijë)